FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: " Upgrade Oracle BI "

Aktiviteti	Koment	M1	M2	M3	M4
Zbatimi i sistemit te ri	Setup i ambientiti si dhe lidhja e sigurte me infrastrukturen ne Port.	X			
Analiza e raporteve ne nevojeshme	Ne kete faze, do te identifikohen nevojat kryesore te portit per Raportime ne sistemin e ri.	X			
Migrimi i Raporteve dhe analizave	Migrimi dhe permiresimi i raporteve, aktuale mbi sistemet:				
	- JDE:		X	X	
	- Pagat dhe Burimet Njerezore			X	
	- Sistemin e Lejeve			X	
Trajnimi dhe fillimi i operimit	Krijimi i profileve te perdoruesve si dhe trajnimi			X	X

Afati i ekzekutimit: 3 (tre) muaj

Data e fillimit të projekti do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e implementimit të sistemit do të jetë si mëposhte:

- 15 dite nga nënshkrimi i kontrates; kerkohet aktivizimi i sistemit si dhe lidhja e tij me infrastukturen ne port;
- 3 Muaj, afati i perfundimit te projektit si dhe fillimi i operimit ne te tre sistemet e lidhura;

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Shiko dokumentacionin ngarkuar ne SPE Termat e References

Objekti: Upgrade i sistemit Oracle BI

1. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1.1. Qëllimi

Qëllimi i krijimit të këtij Sistemi Informatik është:

- Te ofroje versionin me te azhornuar te sistemit te raportimit inteligjent
- Te ofroje nje platforme te aksesueshme nga cdo pajisje dhe nga cdo burim te dhenash
- Te integrohet me sistemet:
 - Sistemi i manaxhimit financiar JDE
 - Sistemi manaxhimit te lejeve ditore/vjetore
 - Sistemi i menaxhimit te Burimeve njerezore, pagave dhe koheshenuesit
- Te migroje dhe permiresoje raportet ekzistuese ne sistemin e raportimit actual
- Te ofroje lehtesira dhe dashboard per shfaqjen e informacionit
- Te trajnoje perdoruesit e APD per krijimin e raporteve dhe dashboardeve ne menyre te pavarur
- Mirembajtje ne vend per 2 vite

1.2. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Kontraktori do te realizoje nepermjet Upgrade te BI, zbatimin e nje platforme te plote dhe efektive qe do te mundesoje:

- Uljen e kosos totale te pronesise
- Reduktimin e përpjekjeve per te vendosur, menaxhuar dhe mirembajtur sistemin e raportimit; Realizimi i perditesimeve ne menyre automatike;
- Rritje dhe fleksibilitet ne perputhje me ndryshimet e biznesit;
- Rregullimin e nevojave duke mundesuar shtimin e sherbimeve dhe kapacitetit ne kohen e pik-ut, duke mos kufizuar performancen e raporteve apo analizave ne vartesi te sasise se te dhenave;

- Ndarjen dhe organizimin e perdoruesve ne nje structure te drejtash ne grupe perdoruesish per administrim te thjeshte te aksesit mbi te dhenat dhe reportet.
- Ofrimin e informacionit ne menyre proactive duke perdorur pajisje mobile
- Kritjen e shpejtesise se kerkimit dhe analizave me te sakta
- Migrimin dhe permiresimin e raporteve ekzistuese ne sistemin actual te raportimit BI
- Trajnimin e perdoruesve mbi gjenerimin e raporteve
- Ofrimin e suportit 2 vite pas zbatimit te kontrates

2. QËLLIMI I PUNËS

2.1. Të Përgjithshme

Organizatata ne ditet e sotme perdorin shume metoda analizimi si psh duke perdorur excel, aplikime desktop, te dhena ne warehouse afatgjata dhe zgjidhje analitike te biznesit. Kjo tregon kerkesen e vazhdueshme per te dhenat, aksesin dhe vizualizimin e te dhenave, te cilat shoqerohen gjithashtu edhe me kostot perkatese. Ne te njejten kohe, kerkohen metoda inovative dhe me te shpejta pa ndikuar ne korrektesine e rezultateve dhe qendrushmerine e tyre. Natyrisht lindin edhe pyetje mbi menyren e menaxhimit dhe fleksibilitetin e te dhenave te marra nga sisteme te ndryshme.

Aktualisht Autoriteti Portual ka ne perdorimin e tij versionin Oracle Business Intelligence 11.1.1.9.0 ku problematika kryesore qe ka aktualisht ky program i analizimit te te dhenave eshte qe nuk aksesohet nga cdo vendndodhje jashte infrastruktures se rrjetit te APD dhe jo nga cdo pajisje. Vec kesaj, lind domosdoshmeri qe te permiresohet dhe thjeshtohet metoda e gjenerimit te raporteve.

Qellimi kryesor i projektit per perditimin e sistemit Oracle BI ne Cloud, do te jete te ofrohet nje zgjidhje e vetme dhe nje platforme e plote qe do te fuqizojë organizaten ne teresi lidhur me kerkesen per marrjen e informacionit nga burime te ndryshme te dhenash, mjedis dhe pajisje. Platforma duhet te pershtatet me ekosistemin e sistemeve qe aktualisht APD ka te implementuara, duke ofruar analiza ne cloud si dhe te ofroje akses ne te gjitha burimet e te dhenave. Kjo do te sjelle perdorimin e plote te te dhenave pavaresisht vendndodhjes se tyre ne kohe reale.

Software analitik i te dhenave te biznesit BI do te ofroje nje sere alternativash te analizimit inteligjent, duke ofruar efektivitet dhe angazhim te me shume punonjesve ne analizen dhe zgjerimin e ekspertizes. Upgrade i sistemit actual Oracle BI ne Cloud, do te ofroje lehtesira dhe do ta beje me te lehte analizen ne cloud si ne ditet e sotme ashtu edhe ne ardhmen.

2.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Hapësira gjeografike janë zyrat administrative te APD.

Te dhenat kerkohet te ruhen n nje platforme Cloud edhe me te sigurte te infrastruktura e brendshme.

2.3. Detyrat specifike

Detyrat kryesore specike që duhet të realizojë kontraktori janë:

- Analiza e projektit për të përcaktuar procedurat e punës dhe funksionalitetet e nevojshme.

- Analiza e projektit në aspektin informatik, për të përcaktuar arkitekturën e sistemit dhe funksionalitetet e nevojshme.
- Hartimi i një dokumenti përshkrues të sistemit të ri (te përditesuar).
- Implementimi i zgjidhjes së re.
- Modifikime dhe personalizime të raporteve në sistemin e ri të raportimit.
- Dorëzimi i manualit të përdorimit.
- Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit)

3. LOGJISTIKA DHE KOHA

3.1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Durrës.

Zhvillimet do të integrohen me sistemin aplikacionet ekzistues Oracle JDE, sistemi leshimit të lejeve, sistemi Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Pagave dhe Koheshënuesit që operohen në serverat e Autoritetit Portual.

Keto sisteme janë në modelin *On-Premise* dhe janë të instaluar në data center të APD.

3.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projektit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e implementimit të sistemit do të jetë si mëposhte:

- 15 dite nga nënshkrimi i kontratës; kërkohet aktivizimi i sistemit si dhe lidhja e tij me infrastrukturën në port;
- 3 Muaj, afati i përfundimit të projektit si dhe fillimi i operimit në të tre sistemet e lidhura;

4. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Funksionalitetet e komunikimit të këtij sistemi me sistemet e tjera ekzistuese tashmë në APD janë:

- Me sistemin e menaxhimit të lejeve;
- Me sistemin e administrimit të brendshëm financiar Oracle JD Edwards;
- Me sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Pagave dhe Koheshënuesit;
- Sistemi i email të brendshëm të APD, do të shërbejë për njoftime automatike për raportimet periodike në sistem.

Komunikimi i sistemit cloud me sistemet *On-premise* duhet të realizohet nëpërmjet një tuneli të sigurtë që lidh datacenter të APD me serverin/sistemin cloud.

5. GARANCIA & MIREMBAJTJA

Periudha e mirëmbajtjes garancisë së sistemit do të jetë për 2 vite.

Përgjigjja dhe shkallëzimi i shërbimit.

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre sipas rëndësisë së tyre.

Kategoria A (Kritik/ i Lartë)	Kategoria B (i Mesëm)	Kategoria C (i Ulët)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre
Zgjidhje alternative e përkohshme		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
<ul style="list-style-type: none"> ○ 15 min. për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 60 min. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ 60 min për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 4 orëve 	<ul style="list-style-type: none"> ○ 120 min për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 48 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

6. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 3 muaj.

Në vijim paraqitet procesi në formën e një diagrame Gant duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen:

Aktiviteti	Koment	M1	M2	M3	M4
Zbatimi i sistemit te ri	Setup i ambientit si dhe lidhja e sigurte me infrastrukturen ne Port.	X			
Analiza e raporteve ne nevojeshme	Ne kete faze, do te identifikohen nevojat kryesore te portit per Raportime ne sistemin e ri.	X			
Migrimi i Raporteve dhe analizave	Migrimi dhe permiresimi i raporteve, aktuale nbi sistemet:				
	- JDE:		X	X	
	- Pagat dhe Burimet Njerezore			X	
	- Sistemin e Lejeve			X	
Trajnimi dhe fillimi i operimit	Krijimi i profileve te perdoruesve si dhe trainimi			X	X

Komponentet kryesore te projektit jane si meposhte:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia
1	Upgrade sistemi Oracle Business Intelligence, perfshire edhe infrastruktura Cloud per 20 perdorues	Vite	2
2	Instalim dhe migrim raportesh mbi sistemet aktuale JDE;	set	1
3	Trajnim stafi	Punonjes	10
4	Garanci per periudhe 2 vjecare	Vite	2

7. KËRKESAT FUNKSIONALE

Upgrade i Oracle BI duhet te kryhet ne nje platforme te sigurte cloud dhe te kombinoje sherbimin ekzistues dhe te ri per te ofruar analizen si dhe paraqitje me te kuptueshme te dhenave. Kjo do te ofroje mundesi standarte te Sigurise si dhe menyra te reja per te shpendare raporte apo analiza per perdorues te vecante, grupe perdoruesish apo analiza te pergjitheshme per te gjitha njesite organizative ne Port.

Sistemi, duhet te ofroje mjetet dhe teknikat per analizen dhe raportimin e te dhenave qenga marrja e te dhenave nga burime te ndryshme, ne zbulimin e shpejte dhe te rrjedhshem deri tek ngarkimi dhe kombinimi i thjeshte apo i sofistikuar i te dhenave, pregatitjen e te dhenave te linjes, pasurimin e te dhenave, pagaqitjen (vizualizimin) automatik, pershkrimin e te dhenave.

Te dhenat dhe reportet kerkohet te kene akses dhe paraqitje te plote ne pajisjet celulare, analitike te thjeshte apo edhe te zgjeruar.

Sistemi i ri BI ne cloud, kerkohet te kete:

- Vetsherbim, qasjen per te mundesuar perdoruesit te krijojne paraqitje grafike per shfaqjen e rezultateve dhe ndarjen e tyre me koleget
- Pregatitjen dhe pasurimin e te dhenave, qe ndertohen ne platformen analitike cloud
- Modelimin e skenareve te biznesit, per analizen multidimensionale dhe analitikes grafike/vizuale
- Akses ne celular qe meson rutinen e perdoruesit dhe jep njohuri ne kohen dhe vendndodhjen e duhur lidhur me aktivitetin e perditshem
- Raportim te operacioneve si dhe sigurine me nje modelim analize qe lidh kompleksitetin e te dhenave ne terma operacionesh te njohura si dhe te mundesoje te dhena te konsoliduara ne nivele te ndryshme te organizates (departamente; projekte apo sherbime).

Upgrade i Oracle BI ne cloud do te jete nje platforme e vetme qendrore me aftesi gjithperfishirese:

- Burim i vetem i te dhenave te rendesishme dhe te verteta te ndermarrjes duke perdorur nje shtrese modelimi te te dhenave
- Analize per cdo nevojë: pershkruese, parashikuese, proaktive
- Analize e drejtuar nga kerkimi ne baze te filtrave te vecanta
- Analize vet-mesimore qe ofron njohuri proactive per paraqitje te dhenave ne celulare
- Krijimin e mundesive per ndryshimin e modelimit te te dhenave ne vartesi te kerkesave ne ndryshim te perdoruesve
- Opsione per ngarkimin dhe perzierjen e te dhenave dhe integrimin midis te dhenave te sistemeve apo njesive te ndryshme
- Pregatitje dhe pasurimi (enrichment) i te dhenave operacionale me te dhenat personale, njesive organizative te vecanta apo ato ne nivel organizate;
- Rrjedhe pune vizuale per automatizimin dhe pasurimin (enrichment) e te dhenave
- Shtrese semantike ne nivel ndermarrje per raportim dhe analize
- Siguri te te dhenave ne nivel analitike. Prsh sistemi mundet te mundesoje paraqitjen e te dhenave ne nivel te agreguar llogarie, por te ndaloje paraqitjen e veprimeve te vecanta
- Sistemi duhet te mundesoje zgjerimin ne cdo kohe te kapaciteteve teknike (processor; disk apo memorie). Ky ndryshim i kapaciteteve duhet te mundesohet ne menyre te vazhdueshme dhe pa sjell nevojen per nderprerjen e sherbimit
- Modelimin e te dhenave te thjeshta apo ne shtresa te ndryshme per te mbeshtetur analizen dhe perkufizimin e biznesit
- Lidhje e optimizuar ne komunikimin/marrjen te dhenat te ruajtura ne sistemet on-premise; per te mundesuar marrjen e diferencuar te te dhenave duke evituar ri-marrjen e te dhenave te marra apo analizuara me pare

Marrja e te dhenave te sakta ne kohen e duhur

Upgrade isistemi te Raportimit BI ne cloud duhet te perdore nje liste ne rritje te burimeve te mundshme te te dhenave, duke i ofruar perdoruesve te sistemit nje menyre te thjeshte per kerkimin si dhe paraqitjen e informacionit qe i nevojitet. Sistemi duhet te ofroje mjete automatike per krijimi e lidhjeve midis sistemeve te brendshme (on-premise) me sistemin BI. Ne menyre te vecante kerkohet:

- Paraqitja grafike/vizualizimi automatik per te gjitha te dhenat te lidhura me sistemin e raportimit si dhe mjete automatike per integrimin e te dhenave qe vijne nga sisteme apo operatione te ndryshme,
- Konektore te ndryshem (pa kufizuar) per lidhje me baza te dhenash kryesore ne treg perfsjire ato Oracle, MySQL, MSSQL; Postgress; MS ACCESS; Excel; CSV etj.. Vec aksesit direkt ne baza te dhenash apo file te strukturuar sistemi duhet te mundesoje edhe lidhje nepemjet JDBC.
- Sistemi duhet te ofroje paraqitje grafike/vizuale te te dhenave si dhe proceseve te perpunimit te te dhenave, duke mundesuar nderhyrjen dhe ndryshimin apo permiresimin e proceseve te pasurimit (enrichment) e te dhenavene menyre sa me te thjeshte, sigurte dhe te kontroluar.
- Të mundesoje zgjerimin grafik te analizes se te dhenave dhe te lehtësoje lidhjen me sistemin BI në aplikacione të tjera. Lidhja duhet te jete e lehte pa nevojën e ndryshimeve ne rrjedhen e te dhenave apo analizes se mepareshme, por vetem te integroje ne te, te dhenat apo analizen e ndryshme te kerkuar nga perdoruesit.

Bashkepunimi dhe ndryshimi i menyres se punes

Sistemi vec, analizes si dhe paraqitjes se te dhenave kerkohet te sherbeje edhe si nje platforme bashkepunimi midis punonjesve apo njesive te ndryshme te Autoritetit Portual. Sistemi duhet te mundesoje krijimin e te dhenave, raporteve apo analizave te perbashketa midis perdoruesve, njesive apo sistemeve apo moduleve te ndryshme, duke perfshire:

- Raportimin ne paisje mobile (mobile apo tablet) ne menyre kontekstuale bazuar mbi veprimet e fundit, gjuhen e perdorur, vendndodhjen, preferenca te ndryshme te perdoruesit, etj..
- Mundesi te shperndarjes, komunikimit dhe bashkepunimit jo vetem per raportet standarde por edhe te analizes, duke ofruar mundesine per komente publike, private dhe shperndarjen e komenteve edhe me palet e treta (duke respektuar percaktimet e sigurise);

Zgjidhje duke dhene opsionin me te mire per biznesin

Sistemi Cloud BI te ofroje fleksibilitet ne rritjen dhe ndryshimin e biznesit si dhe kontroll te plote ne mjedisin analitik:

- Analizoje cdo te dhene dhe kudo ne cloud, on-premise, ose nje ambient mix cloud – on-premise.
- Duke balancuar nevojën per informacion (analitik apo agreguar) te punonjesve dhe strukturave organizative me percaktimet e Portit per shkallen e aksesit per secilen njesi apo perdorues;
- Te pershtatet me kerkesen per ndryshime ne menyre te thjeshte, dinamike ne vartesi te ngarkeses se kapaciteve te perdorura per sistemin. Ne kohe ngarkese, sistemi duhet te vete-pershtatet duke zgjeruar kapacitetet e perpunimit (procesore; disk; memorie apo tjeter te ngjashem);

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8 dhe shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për te pakten një nga vitet e periudhës së kerkuar, të jetë në më një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit të kontratës së shpallur, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara ne organet tatimore.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë :

- **ISO 9001 ose ekuivalente** për menaxhimin e cilësisë
- **ISO 27001 ose ekuivalente** për menaxhimin e sigurisë së informacionit

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete certifikimet si meposhtme per kompanine:

- Certifikaten te kompanise per sisteme Oracle ERP;
- Certifikaten te kompanise per sisteme BI;

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij specialist te certifikuar per sistemet e meposhtme si vijon

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per zbatime sistemesh Oracle ERP.
- 1 (nje) punonjes te certifikuar per raportim BI
- 1 (nje) punonjes te certifikuar per sisteme cloud

Lidhur me personelin e kerkuar, Ofertuesi duhet te paraqesë listepagesat sipas formulareve e-sig/25 te sigurimeve, per te vërtetuar qe i ka te punësuar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, ku te jene te regjistruar kontributet e sigurimeve për secilin prej punonjësve me sipër.

Ky kriter permbushet me plotesimin e formularit te vetdeklarimit sipas shtojcës 9 te DST

Ne zbatim te VKM 285 date 19.05.2022 neni 26 pika 6 " *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*"

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

<p>Deklarata</p>	<p>Përgjigje</p>
-------------------------	-------------------------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>
<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.</p>	<p>Po []</p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me</p>	<p>Po [] Jo []</p>

<p>këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [<input type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [<input type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit 2

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve në Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t’i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

²Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

Vlera _____
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera _____
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsytet e mëposhtme

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsytet e mëposhtme

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

³ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Drejtuesi i Autoritetit /Entit Kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT⁴)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)_____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)_____

⁴ Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

